



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 328, datë 14.06.2023

PËR

**NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 271, DATË 25.05.2023 TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

**“PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË
SHKALLËS SË PARË TIRANË TË RIORGANIZUAR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 66 të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 44 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Në nenin 7 të vendimit nr.271, datë 25.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar” bëhet ky ndryshim dhe shtesë si më poshtë:

a – pas togfjalëshit “Gjykata Administrative” nyja e përparme “**të**” ndryshon dhe zëvendësohet me nyjën e përparme “**e**”;

b - pas togfjalëshit “Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë” duhet shtuar togfjalëshi “**brenda muajit korrik 2023,**”

Pra neni 7 i vendimit të sipërcituar ndryshon si më poshtë:

“Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, brenda muajit korrik 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja në datë 30.06.2023 e aktivitetit ekonomiko-financiar të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë dhe Shkodër.”

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR